

## **RREGULLAT PROMOCIONALE "Madhësia që meritoni!"**

### **1. Organizatori i promovimit**

Samsung Electronics Austria GmbH, me selinë e saj të regjistruar në u Vjenë në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe numrin e regjistrimit FN 217924b (në vijim: "**Samsung**"), po organizon një promovim për blerësit e televizorit Samsung të përcaktuar në paragrafin 7 të këtyre rregullave (në vijim veçmas: **Pajisja**, dhe bashkërisht: **Pajisjet**).

Termi "blerës" i referohet personave fizikë dhe juridikë me vendbanim, ose me seli në territorin e Republikës së Kosovës, të cilët blejnë Pajisje për nevojat e tyre dhe jo për rishitje.

### **2. Periudha promovionale**

Promocioni në fjalë është i disponueshëm për blerësit e Pajisjeve në territorin e Republikës së Kosovës nga data 22 qershor deri më 16 korrik 2023, në përputhje me dispozitat e përmendura në këto rregulla (në vijim: **Rregullat**).

### **3. Përfitimet**

Nëse plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në këto Rregulla, blerësi i Pajisjes do të ushtrojë të drejtën për:

- Pajisjen dhuratë siç përcaktohet në tabelën në pikën 7 të këtyre Rregullave,
- të drejtën për t'iu dërguar dhe instaluar Pajisja,
- të drejtën për 1 (një) zhvendosje të Pajisjes pas dorëzimit dhe instalimit brenda një periudhe 3 (tre) vjeçare pas blerjes së Pajisjes.

### **4. Kushtet për pjesëmarrje në promovim**

Në mënyrë që blerësi i Pajisjes të realizojë të drejtën për të marrë pjesë në aktivitetin promovional si dhe të drejtën e një dhurate nga neni 3, pika 1 i këtyre Rregullave, është e nevojshme të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përmendura:

- a. Blerësi duhet ta blejë pajisjen nga pika 7 e këtyre Rregullave gjatë periudhës së promovimit;
- b. Pajisja duhet të blihet nga një partner i autorizuar i shitjeve Samsung në territorin e Republikës së Kosovës; Lista e partnerëve të autorizuar të Samsung është përcaktuar në pikën 6 të këtyre Rregullave;
- c. Blerësi duhet të regjistrojë me sukses blerjen e Pajisjes, duke dërguar një e-mail në adresën e e-mailit [ce.promotion@samsung.com](mailto:ce.promotion@samsung.com), jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e blerjes së Pajisjes.

Është e mundur të regjistrohen vetëm Pajisjet që janë blerë gjatë periudhës promovionale nga një prej partnerëve të autorizuar të shitjeve të Samsung. Pajisja dhuratë do të dorëzohet në adresën e shtëpisë (pa kosto dërgese) brenda 90 ditëve nga dita e regjistrimit të suksesshëm të blerjes së Pajisjes, për të cilën blerësi do të njoftohet me e-mail në adresën e e-mail-it që ai ka vendosur gjatë regjistrimit të blerjes së Pajisjes. Procedura për regjistrimin e blerjes së një Pajisjeje nënkupton dërgimin e të dhënave të mëposhtme të blerësit të nevojshme për regjistrim të suksesshëm:

- emri dhe mbiemri i personit fizik nëse blerësi është person fizik, ose emri i biznesit të personit juridik nëse blerësi është person juridik,
- adresën e-mail të blerësit,
- adresën e saktë të shtëpisë së blerësit në territorin e Republikës së Kosovës (për qëllime të dërgimit të dhuratave), numrin e telefonit (për qëllime kontakti në lidhje me dërgimin e dhuratave),
- shfaqja (skanimi) i faturës fiskale nga pika e shitjes për të konfirmuar regjistrimin,
- modeli dhe numri serial i Pajisjes.

Në mënyrë që blerësi i Pajisjes të ushtrojë të drejtën e dorëzimit dhe instalimit nga Neni 3, pika 2 e këtyre Rregullave, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përmendura:

- Që blerësi plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, gërmat a. dhe b. të kësaj pike,
- Që blerësi të kontaktojë shërbimin e klientit të Organizatorit duke telefonuar në numrin e telefonit +383 38403110, kohë në të cilën është e nevojshme të jepet informacion për blerjen, Pajisjen dhe të dhënat e tyre personale për qëllime të dorëzimit dhe instalimit të Pajisjes, si dhe të konfirmojë gjithashtu se:
  - është e mundur të dorëzohet Pajisja në adresën e blerësit duke marrë parasysh përmasat e paketimit të pajisjes (2,4m x 1,4m x 0,35m), dhe
  - që sipërfaqja në të cilën është montuar Pajisja është e fortë, e mjaftueshme dhe e përshtatshme për montimin e Pajisjes, duke marrë parasysh përmasat e Pajisjes dhe peshën e Pajisjes (90 kg).

Instalimi i Pajisjes nuk përfshin shërbime shtesë si kalimi i kabllove ose instalimi i elementeve shtesë ose pajisjeve të lidhura. Dorëzimi dhe instalimi i Pajisjes kryhet ekskluzivisht në territorin e Republikës së Kosovës.

Në mënyrë që blerësi i Pajisjes të realizojë të drejtën e zhvendosjes sipas Nenit 3, pika 3 i këtyre Rregullave, është e nevojshme të plotësohen në mënyrë kumulative të gjitha kushtet e përmendura:

- Që blerësi plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, gërmat a. dhe b. të këtyre Rregullave,
- Që dorëzimi dhe instalimi i Pajisjes është kryer në përputhje me paragrafin 3 të kësaj pike,
- Që zhvendosja e Pajisjes të kryhet në një adresë të re që ndodhet në territorin e Republikës së Kosovës,
- Që blerësi të kontaktojë shërbimin e klientit të Organizatorit duke telefonuar në numrin e telefonit +383 38403110 për të paraqitur një kërkesë për zhvendosjen e Pajisjes, rast në të cilin blerësi është i detyruar t'i sigurojë operatorit të dhënat e nevojshme për organizimin dhe kryerjen e zhvendosjes dhe për të konfirmuar gjithashtu se:
  - është i mundur dërgimi i pajisjes në adresën e re të blerësit, duke pasur parasysh dimensionet e paketimit të pajisjes (2,4m x 1,4m x 0,35m), dhe.
  - që sipërfaqja në të cilën kryhet instalimi për të realizuar zhvendosjen e Pajisjes është e fortë, e mjaftueshme dhe e përshtatshme për instalimin e Pajisjes, duke marrë parasysh përmasat dhe peshën e pajisjes (90 kg).

Instalimi i Pajisjeve në procesin e zhvendosjes nuk përfshin shërbime shtesë si kalimi i kabllove ose instalimi i elementeve shtesë ose pajisjeve të lidhura. Instalimi i Pajisjes në procedurën e zhvendosjes kryhet ekskluzivisht në territorin e Republikës së Kosovës.

Kostoja e thirrjes drejtte numrit telefonik fix do të aplikohet sipas tarifave në fuqi të operatorit përkates.

## 5. Verifikimi i kushteve të plotësuara

Organizatori do të kontrollojë nëse data e blerjes së Pajisjes korrespondon me blerjen e bërë në Periudhën Promocionale dhe nëse kushtet e tjera të përcaktuara nga këto Rregulla janë përmbushur. Duke dërguar një e-mail me qëllim të regjistrimit të blerjes së Pajisjes, blerësi jep gjithashtu pëlqimin e tij të shprehur për zbatimin e këtyre Rregullave dhe për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të tij personale në përputhje me dispozitat e këtyre Rregullave.

Blerësi është i detyruar të ofrojë të dhëna të plota dhe të sakta në lidhje me procedurën e regjistrimit për blerjen e Pajisjes, për qëllime të dorëzimit dhe instalimit të Pajisjes dhe zhvendosjen e mundshme të Pajisjes sipas kërkesës së blerësit. Organizatori nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi për rastin e të dhënave të pasakta dhe jashtë afatit. Nëse blerësi nuk i përmbush detyrimet e tij në kohën e duhur, pra nëse të dhënat dhe informacionet e dhëna nga blerësi nuk janë të sakta/të vërteta, blerësi humbet të drejtën e përfitimeve.

## 6. Lista e partnerëve të autorizuar të shitjeve të Samsung

- AZTECH SH.P.K.
- NEPTUN KOSOVA SH.P.K.

## 7. Përcaktimi i pajisjes dhe dhurata përkatëse

Modeli i Pajisjes (pajisjet që janë objekt i Promocionit)	Dhurata përkatëse	Kodi i dhuratës përkatëse
QE98Q80CATXXH	49" DQHD Odyssey G95T	LC49G95TSSPXEN
QE98QN90AATXXH	49" DQHD Odyssey G95A	LS49AG950NPXEN
QE98QN100BTXXH*	49" DQHD Odyssey G95A	LS49AG950NPXEN
	Samsung Galaxy S22	SM-S901BZKDEUE

\*Me blerjen e pajisjes QE98QN100BTXXH blerësi ka të drejtë për 2 (dy) dhurata

## 8. E drejta e ndryshimit dhe hyrja në fuqi

Samsung rezervon të drejtën për të bërë ndryshime në këto Rregulla në çdo kohë, për arsye të justifikuara, me detyrimin për t'i publikuar ato publikisht pa vonesë.

Këto Rregulla janë publikuar në faqen e internetit të Samsung [www.samsung.com/al/offer/big-screen-tv-offer-2023-xk/](http://www.samsung.com/al/offer/big-screen-tv-offer-2023-xk/) më 22 qershor 2023, që nga momenti i zbatimit të tyre.

## **NJOFTIM PËR MBLEDHJEN DHE PËRDORIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Samsung Electronics Austria GmbH, me selinë e saj të regjistruar në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri (në tekstin e mëtejshëm: "**Kontrolluesi**") ju informon këtu për informacionin në lidhje me përpunimin e të dhënave personale:

## **1. Kontrolluesi dhe përpunuesi i të dhënave**

Kontrolluesi i të dhënave personale është Samsung Electronics Austria GmbH, me selinë e regjistruar në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri (në vijim: "**Kontrolluesi**").

## **2. Të dhënat personale të mbledhura:**

Kontrolluesi do të mbledhë dhe përpunojë të dhënat personale të mëposhtme:

- Emri dhe mbiemri,
- Kodi i adresës postare,
- Numri i telefonit të blerësit,
- Adresa e e-mailit të blerësit,
- Modeli dhe numri serial i pajisjes së blerë,

(në vijim: **Të dhënat personale**).

## **3. Qëllimi i mbledhjes së të dhënave personale**

Kontrolluesi do të mbledhë dhe përpunojë të dhënat personale të mësipërme ekskluzivisht për qëllime të përcaktimit të përmbushjes së kushteve për pjesëmarrje në promovimin "Super big Samsung TV98"" dhe realizimin e përfitimeve nëse blerësi ka ushtruar të drejtën për to.

## **4. Mënyra e përdorimit të të dhënave personale**

Të dhënat personale të mbledhura në bazë të pëlqimit do të përdoren ekskluzivisht për nevojat e lartpërmendura të Kontrolluesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Politikën e Privatësisë së Kontrolluesit bashkangjitur më poshtë.

## **5. Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale**

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhënat personale bazuar në pëlqimin vullnetar të personit me të cilin lidhen të dhënat.

## **6. Periudha e ruajtjes së të dhënave personale**

Të dhënat personale do të ruhen vetëm për aq kohë sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e deklaruar, dhe në çdo rast jo më shumë se 6 muaj nga data e blerjes.

## **7. Të drejtat e pjesëmarrësve**

Me kërkesë të pjesëmarrësit, Kontrolluesi do të plotësojë, ndryshojë, përditësojë dhe fshijë të dhënat personale nëse të dhënat janë të paplota, të pasakta ose të vjetruara, dhe nëse përpunimi i tyre nuk është në përputhje me ligjin, ose nëse qëllimi i mbledhjes së të dhënave është përmbushur. Për më shumë informacion, shihni Politikën tonë të Privatësisë ose na kontaktoni duke dërguar një e-mail në adresën [dataprotection.sead@samsung.com](mailto:dataprotection.sead@samsung.com).

Në rast se pjesëmarrësit besojnë se përpunimi i të dhënave të tyre personale cenon privatësinë e tyre, ata mund të kontaktojnë Kontrolluesin e të dhënave personale ose Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe të kërkojnë shpjegim.

## **8. Informacione të tjera**

Për informacion të detajuar mbi masat e marra për ruajtjen e të dhënave personale, si dhe zbulimin e mundshëm të të dhënave personale, lexoni Politikën tonë të Privatësisë.